



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në pajtim me Rregulloren MF nr.04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe neneve 14 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, në Rekomandim të Komisionit vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve për financim publik të projekt propozimeve të OJQ-ve, për organizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive në Komunën e Podujevës, sipas Thirrjes publike për organizimin e aktiviteteve sportive të datës 19.03.2024, merr:

VENDIM
PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ-në KLUBIN E FUTBOLLIT
VETERANËT- LLAPI NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

OJQ Klubi i Futbollit Veteranët - Llapi në Podujevë, për organizimin e aktiviteteve sportive në Komunën e Podujevës sipas Thirrjes publike të datës 19.03.2024 dhe Listës përfundimtare të përfituesve të rekomanduar nga Komisioni vlerësues, mbështetet me mjete financiare në shumë 2000.00 €.

Neni 2

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, për kushtet dhe mënyrën e realizimit të aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, si dhe për mënyrën e financimit publik, me përfituesin e mbështetjes financiare lidhë kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Lista përfundimtare e përfituesve me shumat përkatëse është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.Prot. 02-400/04-0042358/24
01-07-20
Podujevë, datë, 01-07.2024



Nënshkryetarja e Komunës
Mërgona Lahu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8, 11.1 dhe 22 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-413/01 -0071612/23, të datës 27.09.2023, Për Miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 dhe Parashikimet Buxhetore 2025-2026, në implementimin e projektit "Përkrahja me Feferona", në rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0018251/24 të datës 15.03.2024, për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas Ftesës Publike nr.12-320/01-0013313/24, të datës 26.02..2024, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. Lejohen mjete financiare për subvencionimin e 10 (dhjetë) fermerëve përfitues të Komunës së Podujevës për kultivimin e feferonave.

2. Mbështetja e fermerëve do të bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë Pyltariisë dhe Zhvillimit Rural në Ftesën publike "Përkrahje me Feferona", përkatësisht në vlerën prej 500 € për sipërfaqen prej 20 ari me perimkulturë-feferona si vlerë maksimale e mbështetjes për një fermer/e.

Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista e aplikuesve të përzgjedhur për implementimin e projektit: "Përkrahje me Feferona", sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtoria e Bujqësisë Pyltariisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, i cili do të bëjë verifikimin, konstatimin dhe vlerësimin e përmbushjes së kushteve dhe kriterëve nga ana e fermerit/es si dhe çështjeve tjera të parapara sipas ftesës publike përkatëse.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot 02-400/01-0042766/24
Podujevë, datë 02.07.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Balliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjin nr. 08/L-186 për Rregullat e Trafikut e Rrugor , Rregulloren nr. 01/155-352 për Shërbime Publike Komunale dhe nenet 14 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, duke marr parasysh kërkesat dhe nevojat e qytetarëve dhe bizneseve për ofrimin e mundësive për qarkullim me automjete për nevoja të furnizimit të tyre, nxjerr:

V E N D I M

Neni 1

1.Lejohet hyrja dhe qarkullimi me automjete në Bulevardin/ Sheshin e qytetit me qëllim të furnizimit me mallra nga subjektet afariste-S/A të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre biznese në lokalet dhe objektet përgjatë hapësirës së bulevardit.

2.Hyrja me automjete lejohet vetëm për ato biznese të cilat nuk kanë alternativa tjera për furnizim.

Neni 2

Hyrja dhe qarkullimi brenda hapësirës së Bulevardit të qytetit sipas nenit 1 të këtij vendimi lejohet nga ora 06:00 deri më 09:00 të mëngjesit dhe atë shtatë (7) ditë në javë.

Neni 3

Qarkullimi sipas nenit 1 lejohet vetëm për automjetet deri në 3.5t, ndërsa vozitësit gjatë hyrje daljeve obligohen të kenë kujdes të shtuar në ruajtjen e infrastrukturës dhe ambientit të Bulevardit/Sheshit të qytetit.

Neni 4

Nga kufizimi kohor dhe kufizimi në tonazhe i automjeteve sipas këtij vendimi, përjashtohen automjetet/mjetet e ndërmarrjeve publike komunale dhe të kompanive të kontraktuara për kryerje të shërbimeve komunale.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohen të gjitha vendimet tjera me ndryshim plotësimet përkatëse.

Me këtë Vendim njoftohen:

Subjektet afariste përgjatë Bulevardit/Sheshit të qytetit, Drejtoria e Inspeksionit, Policia e Kosovës- Stacioni Podujevë

Nr.Prot. 02-016/01-0042779/24
Podujevë, datë: 02.07.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8, 11.1 dhe 22 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-413/01 -0071612/23, të datës 27.09.2023, Për Miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 dhe Parashikimet Buxhetore 2025-2026, në implementimin e projektit "Përkrahja me Fidane të Dredhëzës, Sistem të Ujitjes dhe Foli", në rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0029138/24 të datës 03.05..2024, për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas Ftesës Publike nr.12-320/01-0022347/24, të datës 05.04..2024, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. Lejohen mjete financiare për subvencionimin e 4 (katër) fermerëve përfitues të Komunës së Podujevës për kultivimin e dredhëzave.

2. Mbështetja e fermerëve bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Ftesën publike "Përkrahja me Fidane të Dredhëzës, Sistem të Ujitjes dhe Foli", në shumë të përgjithshme 6,000.00€ për 4 (katër) fermerët përfitues përkatësisht në shumë prej 1,500.00€ si vlerë e mbështetjes për një (1) fermer/e.

Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista e aplikuesve të përzgjedhur për implementimin e projektit: "Përkrahja me Fidane të Dredhëzës, Sistem të Ujitjes dhe Foli", sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, i cili do të bëjë verifikimin, konstatimin dhe vlerësimin e përmbushjes së kushteve dhe kriterëve nga ana e fermerit/es si dhe çështjeve tjera të parapara sipas ftesës publike përkatëse.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot 02-400/01-0042765/24
Podujevë, datë 02.07.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr. prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr. prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, në kërkesë të Drejtoreshës së Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural –DBPZHR të datës 01.07.2024, merr:

V E N D I M

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas ftesës publike nr.12-320/01-0037290/24 të datës 07.06.2024, për aplikim në projektin furnizim me mekanizëm bujqësor në këtë përbërje:

- **Halit Vërshevc**, udhëheqës i sektorit të shëndetësisë - DSHMS kryesues
- **Remzi Kodraliu**, zyrtar për regjistrim të adresave – DPUMM anëtar
- **Mensur Hoti**, zyrtar për evidentimin e pronës së paluajtshme – DBF anëtar

Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr. prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Anëtarëve të komisionit

Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - DBPZHR.

QSHQ/Arkivit

Nr. Prot. 02-020/04-0043346/24
Podujevë, datë, 04.07.2024.

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

z.Mahmut Ajvazi, zyrtar për ndërtimtari në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mban autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e inspektorit të ndërtimit në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të mbulimit të pozitës së inspektorit të ndërtimit dhe i njëjti vlen deri në rekrutimin e zyrtarit/es në pozitën e cekur konform rregullativës ligjore, apo deri në një akt tjetër administrativ, por jo më gjatë se dy muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 3

E përmendura deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarit _____

Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Inspeksionit, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Zyra e Personelit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

I Autorizuari
Drejtoria e Inspeksionit
Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
Zyra e Personelit
QSHQ/Arkiva

Nr.prot. 02-016/01-0043127/24
Podujevë, datë: 04-07-2024

Kryetari i Komunës
Shpëritim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

znj.Blerina Zeka, zyrtare për ndërtimtari në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mban autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e inspektorit të ndërtimit në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të mbulimit të pozitës së inspektorit të ndërtimit dhe i njëjti vlen deri në rekrutimin e zyrtarit/es në pozitën e cekur konform rregullativës ligjore, apo deri në një akt tjetër administrativ, por jo më gjatë se dy muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 3

E përmendura deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarës *Blerina Zeka*

Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Inspeksionit, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Zyra e Personelit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

E Autorizuara
Drejtoria e Inspeksionit
Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
Zyra e Personelit
QSHQ/Arkiva

Nr.prot. 02-016/01-0043128/24
Podujevë, datë: 04.07.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës, nenin 12 paragrafët 1,2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ të (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, nr. prot. 02-052/09-0044451/24, datë 09.07.2024, nxjerrë këtë;

VENDIM

PËR EMËRIMIN E PËRKOHSHËM NË POZITËN E DREJTORIT TË SHKOLLËS FILLORE TË MESME TË ULËT - SHFMU "JETULLAH ISMAILI" NË FSHATIN DYZ KOMUNA E PODUJEVËS

Neni 1

z. Rrahmon Bulliqi, me nr. personal të letërnjoftimit [redacted], me vendbanim në fshatin Llugë Komuna e Podujevës, i kualifikuar Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe,

Emërohet përkohësisht në pozitën e Drejtorit të SHFMU "Jetullah Ismaili" në fshatin Dyz, Komuna e Podujevës.

Neni 2

I përmenduri sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht deri në zgjedhjen/emërimin e Drejtorit sipas procedurës së rregullt të konkursit apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Kushtet e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

*I dërgohet:
Drejtorisë së Arsimit
Të emëruarit
QSHQ/Arkivit*

Nr. prot. 02-016/07-0044525/24
Podujevë, datë: 09.07.2024

**Kryetari i Komunës
Shefqet Bulliqi**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 parag.1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 12 të Rregullores MF – Nr. – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në kërkesë të Drejtoreshës së Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit nr.prot. 02-400/01-0044780/24, datë 10.07.2024, nxjerr:

VENDIM

PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE OJQ-NË KOMUNËN E PODUJEVËS NË FUSHËN E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT

Neni 1

- 1.Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
- 2.Mbështetja financiare publike e OJQ - ve në Komunën e Podujevës, në fushën e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive ofrohet nga Buxheti i Komunës së Podujevës, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit/nënprogramit 85005.

Neni 2

Mjetet financiare shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas vlerësimit dhe përzgjedhjes nga ana e komisionit si dhe dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përshinë:
 - 1.1. Teksti i thirrjes publike
 - 1.2. Udhëzimet për aplikantët
 - 1.3. Formularët e aplikimit
2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 - 2.1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
 - 2.2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
 - 2.3. Forma e deklarimit të mungesës së fondeve të dyfishta
 - 2.4. Deklarata e Partneritetit

Neni 4

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>.

Neni 5

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, do të formohet Komisioni Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Komisioni Vlerësues punët dhe detyrat do t'i ushtrojnë në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 6

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-401/01-0044836/24
Podujevë, datë: 10.07.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenet 16 dhe 61.3 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, merr këtë:

VENDIM PËR NGRITJEN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR MBIKQYRJEN DHE PËRCJELLJEN E FUSHATËS PËR KORRJE-SHIRJE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN 2024

Neni 1

Ngritet Komisioni komunal për mbikëqyrjen dhe përcjelljen e fushatës për korrje-shirje në territorin e Komunës së Podujevës për vitin 2024, në përbërje:

Rrahman Cakiqi, nga Drejtoria e Inspeksionit - kryesues
Behë Govori- nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltrisë dhe Zhvillimit Rural - anëtar
Ilaz Hoti- nga Shërbimi i Zjarrfikësve - anëtar

Neni 2

Komisioni bën mbikëqyrjen dhe kujdeset për mbarëvajtjen e fushatës së korrje-shirjeve në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Për punën e kryer Komisioni në formë të shkruar informon Kryetarin e Komunës, përmes Drejtoreshës së Drejtorisë së Bujqësisë Pylltrisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Anëtarëve të Komisionit
Drejtoreshës së DBPZHR
Zyrës për Marrëdhënie me Publikun dhe Inform
QSHQ/ Arkivit

Nr. prot. 02-020/04-0045258/24
Podujevë, datë: 17.07.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862, merr:

V E N D I M

Neni 1

Ngritet Grupi punues për hartimin e draft Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingje të Komunës së Podujevës, në këtë përbërje:

Enis Sheholli
Mahmut Ajvazi
Bujar Blaku
Besar Hakiqi
Fatmir Emini

Neni 2

Grupi punues do të hartojë draftin e Rregullores së cekur në përputhje të plotë me rregullativën ligjore në fuqi.

Neni 3

Grupi punues për punën e kryer informon Zyrën e Kryetarit të Komunës përmes Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Nr.Prot. 01-020/04-0045289/24
Podujevë, datë: 11.07.2024



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 9 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, merr:

V E N D I M PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANESAVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e anesave për ndarje të subvencioneve ngritet Komisioni me mandat dy vjeçar në këtë përbërje:

Arbrim Idrizi,	kryesues - <i>Zyra Ligjore.</i>
Vahide Veseli,	anëtare - <i>Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.</i>
Nafie Gërguri,	anëtare - <i>Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.</i>
Genc Gashi,	anëtar - <i>Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.</i>
Besime Veliu,	anëtare - <i>Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.</i>

Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Anëtarëve të komisionit.
Drejtorive përkatëse.
QSHQ/Arkivit.

Nr. Prot. 02-020/04-0045770/29
Podujevë, datë, 15.07.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Buliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva
KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 6 të Udhëzimit Administrativ nr. 11/2010 për Licencimin e Qendrave Rinore dhe neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, në kërkesë të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, nr. prot. 02-020/04-0045612/24, datë 12.07.2024, nxjerr;

VENDIM
PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË
OJQ-ve PËR LICENCIM SI QENDRA RINORE PUBLIKE

Neni 1

Themelohet Komisioni ad-hoc për shqyrtimin e kërkesave të OJQ-ve për Licencim si Qendra Rinore Publike në Komunën e Podujevës, në këtë përbërje,

Blerina Fejzullahu Kika, kryesuese
Mensur Hoti, anëtar
Rines Kastrati, anëtar

Neni 2

Komisioni sipas nenit 1 të këtij Vendimi, pas shqyrtimit të kërkesave të OJQ-ve, për Licencim si Qendra Rinore Publike në Komunën e Podujevës, përgatit në formë të shkruar raport me rekomandime dhe të njëjtin ia paraqet Kryetarit të Komunës, përmes Drejtoreshës së Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Drejtorisë Kulturës Rinisë dhe Sportit
Anëtarëve të Komisionit
QSHQ/Arkivit

Nr. Prot. 02-020/04-0046128/24
Podujevë, datë: 16.07.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliq





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronjat b), c) dhe g), ndërlidhur me nenin 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 61 paragrafët 1.2) 1.3) dhe 1.7) ndërlidhur me nenin 64 paragrafët 3 dhe 4 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, jep këtë:

AUTORIZIM

Autorizohet znj. Marigona Lahu, Nënkyetare e Komunës së Podujevës, që në emër të Komunës, të nënshkruaj;

-*Memorandum Bashkëpunimi* me Agjencinë Kadastrale të Kosovës për implementimin e kapitullit të shtatë VII (Rindërtimi i Kadastrit) të Ligjit nr. 08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme dhe Udhëzimit Administrativ nr.11/2024 për Procedurën e Rindërtimit të Kadastrit.

Bashkëngjitur: Drafti përkatës i Memorandumit.

Nr.prot. 02-0166/0046277/24
Podujevë, datë: 16.07.2024



Shpejtim Bulliqi
Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 6, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 06-400/04-0042077/24, të datës 28.06.2024, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Shaban Krasniqi, me numër personal të letërnjoftimit [redacted] nga fshati Breznicë, Komuna e Vushtrisë, me rastin e sjelljes së donacionit autoambulancës nga shteti Suedez, për nevojat e QKMF-së Podujevë, për mbulimin e shpenzimeve me rastin e transportimit të automjetit të cekur, mbështetet me mjete financiare në shumë 1,500.00€.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë bankare e të përmendurit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.
Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF
QSHQ/Arkivit.
z.Shaban Krasniqi (njoftohet përmes DSHMS-së)

Nr.prot 02-400/03-0046726/24
Podujevë, datë, 18.07.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

z.Fehmi Tahiri, inspektor i tregut në Drejtorinë e Inspeksionit, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mban, autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e inspektorit të shërbimeve publike, në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Autorizimi jepet duke marrë për bazë vëllimin e punëve në fushën e cekur më lart dhe vlen deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

I përmenduri deponon nënshkrimin në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarit _____

Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Inspeksionit dhe Zyra e Personelit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

I Autorizuari
Drejtoria e Inspeksionit
Zyra e Personelit
QSHQ/Arkiva

Nr.prot.02-112/02-00474/13/24
Podujevë, datë: 22.07.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

z.Qefser Vershevc, inspektor i tregut në Drejtorinë e Inspeksionit, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mban, autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e inspektorit të shërbimeve publike, në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Autorizimi jepet duke marrë për bazë vëllimin e punëve në fushën e cekur më lart dhe vlen deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

I përmenduri deponon nënshkrimin në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarit

Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Inspeksionit dhe Zyra e Personelit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Me këtë vendim njoftohen:

I Autorizuari
Drejtoria e Inspeksionit
Zyra e Personelit
QSHQ/Arkiva

Nr.prot. 02-112/02-0047417/24
Podujevë, datë: 22.07.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujevo

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1


z.Bujar Aliu, inspektor i tregut në Drejtorinë e Inspeksionit, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mban, autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e inspektorit të shërbimeve publike, në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Autorizimi jepet duke marrë për bazë vëllimin e punëve në fushën e cekur më lart dhe vlen deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

I përmenduri deponon nënshkrimin në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarit 

Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Inspeksionit dhe Zyra e Personelit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

I Autorizuari
Drejtoria e Inspeksionit
Zyra e Personelit
QSHQ/Arkiva

Nr.prot. 02-112/02-0047415/24
Podujevë, datë: 22.07.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

z.Valon Çitaku, inspektor i tregut në Drejtorinë e Inspeksionit, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mban, autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e inspektorit të shërbimeve publike, në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Autorizimi jepet duke marrë për bazë vëllimin e punëve në fushën e cekur më lart dhe vlen deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

I përmenduri deponon nënshkrimin në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarit _____

Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Inspeksionit dhe Zyra e Personelit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Me këtë vendim njoftohen:

I Autorizuari
Drejtoria e Inspeksionit
Zyra e Personelit
QSHQ/Arkiva

Nr.prot. 02-11262-0047414/24
Podujevë, datë: 22.07.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11 dhe 58 shkronjat a) b), c) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 61 paragrafët 1.2) 1.3) dhe 1.7), nenet 14 dhe 64 paragrafët 1.1) 1.2) dhe 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, jep këtë:

AUTORIZIM

Autorizohet znj. Lirie Hoti, Drejtoreshë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Komunës së Podujevës, që në emër të Komunës, të nënshkruaj;
-Vendimin për shkëputje të Kontratës me nr. prot. 02-324/01-0060419/17, datë 07.08.2017 për dhënien në menaxhim me qira të vend gjuetisë së përbashkët “Podujeva”, e lidhur në mes Komunës së Podujevës, në cilësinë e qiradhënësit dhe Shoqatës së Gjahtarëve “Llapi” në Komunën e Podujevës në cilësinë e qiramarrësit.

Autorizimi jepet në zbatim të Vendimit nr. prot. 210/24 datë 17.05/2024 të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural / Departamenti Qendror i Inspeksionit për Pylltari dhe Gjueti, sipas të cilit ndër tjera është obliguar Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për që të bëjë rishqyrtimin e kontratës dhe të njëjtën ta shkëputë për shkak të mos menaxhimit sipas obligimeve ligjore dhe kontraktuale, duke e bërë këtë Drejtori edhe përgjegjëse për zbatimin e Vendimit të cekur.

Bashkëngjitur:

- Vendimi i MBPZHR / Departamenti Qendror i Inspeksionit për Pylltari dhe Gjueti nr. 210/24 datë 17.05.2024
- Kontrata nr. prot. 02-324/01-0060419/17, datë 07.08.2017 për dhënien në menaxhim me qira të vend gjuetisë së përbashkët “Podujeva”

Nr.Prot. 02-016/01-004783/1/24
Podujevë, datë: 23.02.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenet 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, konform Ftesës Publike nr. prot.15-300/01-0046137/24, datë 16.07.2024 të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE, nxjerr:

VENDIM

Neni 1

Për shqyrtimin e aplikacioneve për ndarjen e shtëpizave të drurit sipas Ftesës Publike të DPZHE për projektin **“Ditët e Diasporës”** që ka për qëllim rritjen e aktiviteteve argëtuese dhe promovuese për qytetarët e Komunës së Podujevës me rastin e ardhjes së bashkatdhetarëve gjatë sezonit të verës, ku do të ofrohen shërbime të gastronomisë, ngritet komisioni në përbërje:

Emine Muçolli Tahiri, kryesuese
Shkurte Musa, anëtare
Rilind Babatinca, anëtar

Neni 2

Komisioni, bën shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve si dhe përzgjedhjen e aplinaktëve / bizneseve që do të ushtrojnë veprimtaritë e tyre në shtëpizat e drurit në Sheshin “ Katër Dëshmorët”, sipas projektit të publikuar me Ftesën Publike.

Neni 3

Komisioni për punën e kryer, në formë të shkruar e informon Kryetarin e Komunës, përmes Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Anëtarëve të Komisionit
Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-020/04-0048154/24
Podujevë, datë: 24.07.2024



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, në zbatim të Kontratës nr. prot. 02-016/01-0046604/24 (i Komunës) dhe nr. prot 76/I (i NPL EKO Llapit- SHA) datë 17.07.2024, nxjerr:

V E N D I M **PËR MENAXHMIN E KONTRATËS SË SHËRBIMEVE/PUNËVE**

Neni 1

Për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e kontratës për kryerjen e shërbimeve/punëve të përcaktuara sipas Kontratës nr. prot. 02-016/01-0046604/24 (i Komunës) dhe nr. prot 76/I (NPL EKO Llapit- SHA) të lidhur në mes Komunës së Podujevës dhe NPL EKO Llapit – SHA, më 17.07.2024, caktohet:

Remzi Kodraliu, Menaxher i kontratës.

Neni 2

I caktuari punët dhe detyrat i ushtron në përputhje me kontratën e cekur sipas nenit 1 të këtij Vendimi.

Neni 3

I përmenduri për punën e kryer Informon Zyrën e Kryetarit në formë të shkruar.


Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:
Të caktuarit
NPL EKO Llapit- SHA
QSHQ/Arkivit*

Nr.prot. 02-020/05-0048153/24
Podujeve, datë: 24.07.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 4 dhe 127 paragrafi 4 të Ligjit nr. 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor si dhe nenin 16 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

Ndalohet ngasja e motoçikletave, biçikletave, trotineteve elektrike dhe mjeteve tjera të ngjashme brenda hapësirës së Sheshit/Bulevardit të qytetit.

Neni 2

Masa e ndalimit të ngasjes së mjeteve sipas nenit 1 bëhet për shkak të pengimit të qarkullimit të lirë të qytetarëve në Sheshin/Bulevardin e qytetit dhe me qëllim të parandalimit të çfarëdo forme të rrezikimit apo të lëndimit të qytetarëve, si dhe të evitimit të ndonjë dëmi eventual.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi dhe autorizimeve tjera përkatëse nga Ligji për Rregullat e Trafikut Rrugor dhe dispozitave të akteve tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi kujdesen Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Drejtoria e Inspeksionit, në bashkëpunim dhe koordinim me Policinë e Kosovës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive të cekura

Policisë së Kosovës-Stacionit Policor Podujevë

Zyrës për Marrëdhënie me publikun dhe Informim

QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-343/01-0049446/24
Podujevë, datë: 25.07.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, në zbatim të Kontratës nr. prot. 02-016/01-0046605/24 (i Komunës) dhe nr. prot 77/I (i NPL EKO Llapit- SHA) datë 17.07.2024, nxjerr:

V E N D I M **PËR MENAXHMIN E KONTRATËS SË SHËRBIMEVE/PUNËVE**

Neni 1

Për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e kontratës për kryerjen e shërbimeve/punëve të përcaktuara sipas Kontratës nr. prot. 02-016/01-0046605/24 (i Komunës) dhe nr. prot 77/I (NPL EKO Llapit- SHA) të lidhur në mes Komunës së Podujevës dhe NPL EKO Llapit – SHA, më 17.07.2024, caktohet:

Naser Rama, Menaxher i kontratës

Neni 2

I caktuari punët dhe detyrat i ushtron në përputhje me kontratën e cekur sipas nenit 1 të këtij Vendimi.

Neni 3

I përmenduri për punën e kryer Informon Zyrën e Kryetarit në formë të shkruar.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Të caktuarit
NPL EKO Llapit- SHA
QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-020/05-0048462/24
Podujeve, datë: 25.07.2024

Kryetari i Komunës
Shpetim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafët 3.1, 3.2 dhe 3.6, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 06-400/04-0047561/24, të datës 22.07.2024, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj. [redacted] nga Podujeva, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor të vëllait të saj Ermal Demëahmeti si dhe gjendjes së rënduar të banimit dhe ekonomiko-sociale të familjes së saj, i jepet ndihmë financiare në shumë 1,500.00€.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat barten përmes bankës në llogarinë bankare të së përmendurës znj. [redacted]

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS

Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF

QSHQ/Arkivit

Znj.Flutura Demëahmeti (njoftohet përmes DSHMS-së)

Nr.prot. 02-401/07-0048664/24
Podujevë, datë, 25.02.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8 dhe 22 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot. 01-413/01-0071612/23, të datës 27.09.2023 për Miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 dhe Parashikimet Buxhetore 2025-2026, në implementimin e projektit ”Përkrahja me mëshqerra”, në rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0028042/24, të datës 29.04.2024 për Shqyrtimin edhe Vlerësimin e Kërkesave për Ndarje të Subvencioneve sipas Ftesës Publike nr.12-320/01-0021274/24, të datës 02.04.2024, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. Lejohen mjete financiare për subvencionimin e 150 (Njëqind e pesëdhjetë) fermerëve përfitues të Komunës së Podujevës për projektin ”Përkrahje me mëshqerra”.

2. Mbështetja e fermerëve do të bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Ftesën publike për aplikim në projektin ”Përkrahje me mëshqerra”, përkatësisht fermerët përfitues do të participojnë 30% të vlerës së projektit, kurse pjesa tjetër e projektit mbështetet nga Komuna.

Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista e aplikuesve të përzgjedhur për implementimin e projektit: ”Përkrahje me mëshqerra” sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Komisionin për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, i cili do të bëjë verifikimin, konstatimin dhe vlerësimin e përmbushjes së kushteve dhe kriterëve nga ana e fermerit/es si dhe çështjeve tjera të parapara sipas ftesës publike përkatëse.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot 02-400/07-0048961/24
Podujevë, datë 26.07.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13, ndërlidhur me nenet 17 shkronjat a) b) f) dhe nenin 58 shkronjat b) g) të Ligjit nr.03/L-040, nenit 14, ndërlidhur me nenin 19 paragrafët 1.1; 1.2; dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, nxjerrë këtë;

V E N D I M **PËR NGRITJEN E GRUPIT PUNUES**

Neni 1

Ngritet Grupi Punues për caktimin e zonave, vend-parkingjeve publike si dhe caktimin dhe kategorizimin e çmimeve, sipas llojeve të vend-parkimeve në territorin e Komunës së Podujevës, në këtë përbërje:

- **Leutrim Krasniqi**, Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
- **Bahri Selimi**, Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit
- **Fatlum Osmani**, Drejtorja e Buxhetit dhe Financave, dhe njëkohësisht i Autorizuar për ushtrimin e funksionit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë
- **Alban Zeka**, Drejtorja e Inspeksionit
- **Vigan Salihu**, Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik

Neni 2

Grupi punues sipas këtij vendimi, përgatit dokumentet përkatëse sipas Planeve komunale dhe vizionit të Komunës, të cilat do të jenë pjesë përbërëse / shtojcë e Draftit të Rregullores për organizimin dhe shfrytëzimin e vend-parkingjeve të Komunës së Podujevës, dhe atë, ndër të tjera eventuale:

1. Caktimin e Zonave, vend-parkingjeve publike dhe hapësirave për vend-parkime, sipas kësaj ndarje;

- ZONA I (qendra e qytetit) që përfshin hapësirën brenda dhe përgjatë perimetrit të zonës qendrore urbane të Qytetit të Podujevës
- ZONA II - hapësira që përfshihet nga përfundimi i Zonës I, përgjatë dhe brenda zonës urbane të Qytetit të Podujevës.
- ZONA III - hapësira që përfshihet nga përfundimi i Zonës II deri në kufijtë e përfundimit të zonës urbane.
- Hapësirat Rezidenciale; Hapësirat Komerciale dhe Hapësirat e Kombinuara.
- Formën se si duhet të jenë dimensionet e gjatësisë dhe gjerësisë së vend-parkingjeve, këndet, vijëzimi / shenjëzimi, mënyra e parkimit, varësisht nga lloji i rrugës njëkahore apo dykahore, përfshirë edhe parkingjet private.

2. Caktimin dhe kategorizimin e çmimeve / çmimoren sipas llojeve të vend-parkimeve publike që parashihen në Draftin fillestar të Rregullores për organizimin dhe shfrytëzimin e vend-parkingjeve të Komunës së Podujevës, dhe atë:

- Vend-parkimet përgjatë rrugëve publike dhe hapësirave të destinuara si vend parkime publike në të cilat përfshihen edhe vend parkimet me laura të mbyllura;
- Vend-parkimet "Parko & Udhëto" (Park & Ride);
- Vend-parkimet me Partneritet Publiko Privat PPP - garazhet; (bëhet sipas projekteve përkatës me PPP)
- Vend-parkimet publike për banorë rezidentë;
- Vend-parkimet publike të përhershme apo të përkohshme, rrugore dhe jashtë-rrugore, si dhe çdo hapësirë tjetër publike e cila mund të shfrytëzohet si vend-parkim publik;

- Vend-parkimet e përkohshme publike në të cilat parkimi paguhet gjatë organizimit të përkohshëm të komunikacionit, gjatë organizimit të manifestimeve të ndryshme, ngjarjeve dhe të ngjashme;
- Vend-parkimet rrugore publike të cilat gjenden në rrugë dhe trotuare, të shënuara në mënyrë të veçantë me shenja horizontale dhe vertikale, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor dhe me dokumentacion teknik;
- Vend-parkimet jashtë rrugore publike të cilat gjenden jashtë rrugës dhe të shënuara me shenjat horizontale dhe vertikale, e të cilat përcaktohen me projekt të veçantë;
- Vend-parkingjet tjera të cilat do të menaxhohen nga NPL "Eko-Llapi" Sh.A. e që do të definojnë përmes segmenteve të kodifikuara që duhet të jenë të ndërlidhura me adresën përkatëse.

Neni 3

Me Rregulloren e lartcekur Komuna e Podujevës ka për qëllim përcaktimin e kushteve dhe kritereve të vend-parkimeve publike dhe private, caktimi i zonave, mënyra e pagesës, çmimet dhe llojet e biletave për vend-parkim, procedura e paraparë për krijimin dhe operimin e parkingjeve private, mënyra e shfrytëzimit të tyre dhe mbikëqyrjen për parkimin e automjeteve në gjithë territorin e Komunës së Podujevës, dhe gjithë kjo (përjashtim parkingjeve private) synohet të administrohet dhe menaxhohet nga NPL "Eko-Llapi" Sh.A. në Podujevë. Pra bëhet fjalë për hapësira publike që janë hapësirë e dedikuar për vend-parkimin e automjeteve, e cila është e rregulluar si vend-parkim, e shënuar me shenja të komunikacionit dhe me informata rreth zonës së parkimit dhe çmimeve varësisht nga koha e parkimit dhe mënyrës së pagesës së parkimit, hapësirë e cila po ashtu përfshin edhe segmentet të cilat janë pjesë e hapësirës publike të parkingut siç janë hapësirat e mesme për qarkullim të automjeteve në vend-parking, ishujt dhe oazat gjelbëruese, si dhe trotuaret përreth vend-parkingut, segmente këto të cilat duhet të jenë të sinjalizuara.

Neni 4

Grupi punues sipas këtij vendimi bashkëpunon dhe koordinon punën me Grupin Punues përkatës për hartimin e Draftit fillestar të Rregullores për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Podujevës i ngritur me vendim nga Kryetari i Komunës, si dhe me Drejtoritë dhe shërbimet tjera të Komunës.

Neni 5

Grupi Punues sipas këtij vendimi angazhohet për kryerjen e punëve dhe përgatitjen e dokumenteve përkatëse sipas Planeve komunale dhe vizionin e Komunës, në një afat sa më optimal të mundshëm, dhe për punën e kryer informon në formë të shkruar Zyrën e Kryetarit të Komunës.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.Prot. 02-020/04-0049544/24
Podujevë, datë, 30.07.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 63.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nenin 19 parag. 2.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe nenin 65.1 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, sipas Formularit/deklaratës së Drejtorit të DPUMM për konflikt të interesit nr. prot. 02-016/01-0049447/24, datë 29.07.2024, nxjerr:

V E N D I M

-Bahri Selimi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit autorizohet/caktohet për shqyrtimin e kërkesës nr. prot.07-350/04-0049386/24, datë 29.07.2024 për kushte dhe leje ndërtimore për ngastrën nr. 00963-12, Zona Kadastrale Majac, të parashtuar dhe në pronësi të Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit- DPUMM z. Leutrim Krasniqi.

-Bartja e të drejtës së shqyrtimit të kërkesës për kushte dhe leje ndërtimore sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet për shkak të rrethanave të konfliktit të interesit, ekzistimit të interesit privat të z. Leutrim Krasniqi Drejtor i DPUMM.

Arsyetim

z. Leutrim Krasniqi, Drejtor i DPUMM ka parashtuar kërkesën nr. prot.07-350/04-0049386/24, datë 29.07.2024 për kushte dhe leje ndërtimore për ngastrën nr. 00963-12, Zona Kadastrale Majac, në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

I përmenduri në këtë rast ka konstatuar se ka konflikt të interesit, ngase është bartës i kërkesës për kushte dhe leje ndërtimore për ngastrën e cekur, duke deklaruar vetë tërheqjen nga procesi i shqyrtimit dhe vendosjes, përmes Formularit për deklarimin e konfliktit të interesit nr. prot. 02-016/01-0049447/24, datë 29.07.2024.

Duke iu referuar dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, për nënshkrimin e dokumentit në fjalë autorizohet/caktohet z.Bahri Selimi Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

U dërgohet:
Drejtorëve të Drejtorive përkatëse
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-016/01-0049599/24
Podujevë, datë: 30.07.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulhiqi

